



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Informatë për vitin 2022 – Janar – Qershor

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK

ZKKK- Koordinon të gjitha punët me të gjitha Drejtoritë Komunale, Kuvendin Komunal dhe trupat e tij: Komiteti për Buxhet dhe Financa, Komiteti për Komunitete, Zyra për të Drejtat e Njeriut, Njësi për Barazi Gjinore, për Integritet Evropian, Zyrën për Informim. Poashtu ZKKK ka bashkëpunim edhe me Institucionet e Sigurisë: Policia e Kosovës (PK), KFOR-in, FSK-në dhe Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.

-Bashkëpunim me nivelin qendror që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejta apo të tërthorta për Çështjen e Komuniteteve jo-shumicë; Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Zyra e Kryeministrit – Zyra për Çështje të Komuniteteve jo-shumicë, Zyra e Presidentit/es për Komunitetet jo-shumicë, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Financave (MF) dhe ministrinë tjera shtetërore.

- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë:

ZKKK - Bashkëpunon edhe me Organizatat Ndërkombëtare: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar i SHBA-së (USAID), Caritas Zvicrran, URA 2 si dhe Organizata Joqeveritare vendore si: OJQ – Organizata e komuniteteve jo-shumicë “Qendrimi” në Podujevë etj.

ZKKK Aktivitetet

Programi për Stabilizim të Komuniteteve jo-shumicë, Komuna e Podujevës në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM), në bashkëfinancim ka realizuar shumë projekte për Stabilizimin socio-ekonomik të komuniteteve jo-shumicë, projekte të bizneseve të vogla ku financohen nga grantet e Bashkimit Evropian dhe menaxhohen nga Zyra e BE-së në Kosovë.

Qëllimi i bizneseve të vogla të cilat mund të dëshmojnë realizueshmëri dhe qëndrueshmëri ekonomike që gjenerojnë mundësi punësimi dhe krijojnë të ardhura familjare.

- Projekte edhe në ato shkolla ku ka nxënës të komuniteteve jo-shumicë, me kabinete, fusha sportive etj.

- Njëherit Komuna – Drejtoria e Arsimit (DKA) mbështeti implementimin e projektit për përkrahjen e SHFMU “Shaban Shala”, furnizimin me pajisje për Kabinetet e Shkollës për lëndët: Kimi, Fizikë, Biologji, Gjeografi, Histori dhe inventar të nevojshme.

- Projekti ka kushtuar 11.800€, ku BE-ja ka financuar me 8.260€. Komuna – DKA, kontribuoj në vlerë 3.540 € në bashkëfinancim të këtij projekti.

-Projekte individuale për komunitetet jo-shumicë

Farkatari Halil Bahtiri me projektin individual ka përfituar mjete pune me vlerë financiare 2.900€ pa participim, projektet vazhdojnë edhe në të ardhmen.

-Aktivitet: ZKKK-ja në koordinim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) dhe përfaqësuesit e Komunitetit Ashkali kanë mundësuar organizimin e Festës Kombëtare të Flamurit të Komunitetit Ashkali. Duke falënderuar DKRS-në që i ka ndihmuar me mjete financiare. Në këtë manifestim ishin prezent edhe Zyrtarët Komunalë.

-Aktivitet: ZKK-ja takim pune me përfaqësuesit e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) lidhur me personat e kthyer nga Vendet e Konfliktëve - Luftërave të ndryshme e sidomos me çështjen e ekstremizmit fetar, ideologjik, racor etj, dhe për integrimin dhe stabilizimin e tyre në shoqërinë kosovare.

-Aktivitet: Takim pune me Qendrën për Punë Sociale (QPS) lidhur me personat – familjet nga komunitetet që janë në Asistencë Sociale.

* Komuniteti Shumicë Shqiptarë ka 875 familje me 4013 anëtarë me asistencë sociale.

* Komuniteti Ashkali; 72 familje me 396 anëtarë

* Komuniteti Rom; 5 familje me 36 anëtarë. Komunitet jo-shumicë; 77 familje me 432 anëtarë.

-Aktivitet: Takim pune me Entin e Punësimit. Tek Zyra për Punësim për Vitin 21/22 janë të lajmëruar 32 persona si të papunë nga komuniteti jo-shumicë.

-Aktivitet: Takim pune me Caritasin Zvicrran me temën “Hartimi i Planit Komunal për Ri-integrim dhe Diasporë”. Qëllimi kryesor i tryezës ishte diskutimi dhe analiza e realizimit të Planit Komunal për Ri-integrim të vitit 2019-2022, ku u diskutuan sfidat, nevojat për grumbullimin e të dhënave nga institucionet përkatëse që meren me procesin e Riatdhesimit dhe Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar si dhe përgatitjen e Planit të Veprimtimit Komunal për Ri-integrim për periudhën kohore 2023-2025.

Njëkohësisht, Komuna ka hartuar Planin për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Podujevës për vitin 2021-2025. Ky plan ka derivuar nga Strategjia e Qeverisë së Kosovës duke ia shtuar specifikat dhe rrethanat të cilat e karakterizojnë gjendjen e komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Podujevës.

Informatë

Të gjithë personat e Riatdhesuar fillimisht vijnë në Zyrën për Integritime Evropiane dhe Zyrën për Komunitete dhe Kthim që të lajmërohen si të riatdhesuar, të dhënat e tyre futen në programin elektronik të Riatdhesimit SMR (Sistemi për Menaxhimin e Rasteve) pastaj iu lëshohet një konfirmim që personi është i riatdhesuar dhe drejtohen tek Enti për Punësim që të regjistrohen si punë kërkues. Pastaj, Enti për Punësim i referon rastet tek Qendra e Aftësisë Profesionale (QAP) në Prishtinë që të shkojnë atje të ndjekin një trajnim në fusha të caktuara që iu përshtatet më shumë këtyre personave dhe kanë pak a shumë njohuri për atë drejtim dhe pas përfundimit të trajnimit pajisen me certifikatë për vetëpunësim dhe pas daljes së shpalljes për aplikim për themelim biznesi ata aplikojnë prapë përmes Entit të Punësimin, ku shumica të cilët e kanë dokumentacionin e kompletuar mund të përfitojnë dhe të hapin bizneset e tyre në komunë. Monitorimet e bizneseve i bën Zyra për Integritime Evropiane, Zyra për Komunitete dhe Kthim ZKKK dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Gjatë vitit 2022 në Komunën tonë janë riatdhesuar vetëm 18 persona, ku 2 prej tyre janë të komunitetit ashkali dhe 16 shqiptarë. Prej të gjithë këtyre personave 3 janë nxënës të shkollave fillore.

Familjet të cilat kanë pasur nevojë për ndihmë emergjente janë të renditura më poshtë:

- 1 familje ka përfituar strehim të përkohshëm
- 2 persona kanë përfituar trajtim mjekësor dhe medikamente
- 1 familje ka kërkuar që të hyjë në skemë sociale.

Në skema për themelim biznesi përfshihen edhe personat që janë riatdhesuar edhe më herët ku gjatë kësaj periudhe kanë aplikuar 58 persona për themelim biznesi ku shumica prej tyre kanë përfituar dhe kanë hapur bizneset në qendrën për regjistrim të bizneseve në Komunën e Podujevës.

Këta persona janë referuar nga Zyra për Integritime Evropiane dhe Zyra për Komunitete dhe Kthim që të shkojnë dhe të kërkojnë ndihmë nga organizatat e huaja e sidomos ato gjermane siç janë: IOM, URA 2 dhe AWO NURNBERG, ku disa prej tyre të cilët kanë qenë brenda kriterëve të parapara janë ndihmuar nga këto organizata me çfarëdo lloj ndihme duke filluar nga pako ushqimore e higjienike, strehim, medikamente, orëndi shtëpiake, renovim të shtëpive, mjete financiare etj.

Shumica e këtyre personave të riatdhesuar janë orientuar më së shumti tek projekti për vetëpunësim Themelim Biznesi i cili financohet nga Ministria e Punëve të Brendshme MPB dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale MPMS dhe menaxhohet nga organizata UNDP me mjete pune në vlerë deri në 3000€.

-Aktivitet: Punëtori Rajonale për Hartimin e Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Shoqërinë Kosovare.

Synimi i punëtorisë ka qenë angazhimi i nivelit lokal në parafrimin e perspektivave të nivelit lokal me objektivat strategjike, objektivat specifike treguese dhe aktivitetet në Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2022-2026.

-Aktivitet: Trajnim në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK), me temën “Përdorimi i

databazës së re të të dhënave”. MKK në përputhje me Rregulloren (QRK) – nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme ku është themeluar Komisioni Komunal për Kthim të Qëndrueshëm prej 7 anëtarëve që janë zyrtarë komunalë. ZKKK-ja është kryesuese dhe përfshihen edhe dy anëtarë tjerë, njëri nga MKK dhe tjetri nga UNHCR.

- Caktimi i dy zyrtarëve përgjegjës për Qasje dhe regjistrimin e Aplikacioneve në Bazën e të Dhënave të MKK-së që të kemi bashkëpunim në linjat e nivelit qendror dhe lokal lidhur me kërkesat e PZH (personave të zhvendosur) për kthimin e tyre që të kemi të gjitha të dhënat e sakta, në bashkëpunim me MKK-në, UNHCR-në dhe ZKKK-në.

-Aktivitet: Trajnim nga MPB (Ministria e Punëve të Brendshme)

Departamenti për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me UNHCR-në dhe Programin për të Drejtat Civile në Kosovë (CRPK). Zbatimin në praktikë të udhëzuesit për procedurat, strandardet të Veprimit për Integrimin e të Huajve në Republikën e Kosovës, roleve, kritereve dhe procedurave në ofrimin e shërbimeve për personat e huaj të cilët kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare në Republikën e Kosovës që atyre t’iu mundësohet trajtimi institucional dhe ligjor për të gjitha të drejtat për integrimin e tyre në të gjitha fushat e jetës.

-Aktivitet: ZKKK-ja Takim pune me Kryetarin e Komunës, me ish - deputetë të komuniteteve jo-shumicë të Parlamentit të Kosovës dhe me përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë. Tema ishte për gjendjen e komuniteteve jo-shumicë ku u informuan nga ZKKK-ja për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me jetën e tyre dhe mundësitë tona institucionale për t’iu dalë në ndihmë për një mirëqenie më të mirë socio-ekonomike si dhe mundësi tjera siç ishin: strehimi, banimi, punësimi, shëndetësia, arsimiti, infrastruktura etj. Patën një përkrahje nga Kryetari i Komunës për angazhimin e vazhdueshëm në krijimin e kushteve për jetesë dhe mirëqenie ekonomiko-sociale të komuniteteve jo-shumicë.

Komuna ka bërë maksimumin e mundshëm për të arritur Stabilizimin dhe Integrimin e tyre në shoqëri dhe në fusha tjera, siç janë: arsimiti, shëndetësia, punësimi, banimi, mirëqenia sociale, infrastruktura, media, kultura, rinia, sporti etj. Përkundër angazhimeve dhe projekteve për mirëqenie të këtyre minoriteteve, akoma mbetet për të punuar në këtë drejtim, sepse nevojat dhe kërkesat e tyre, në aspektin socio-ekonomik janë më të mëdha.

Raport nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për familjet e komuniteteve jo-shumicë të ndihmuara me Subvencione dhe Donacione

Subvencionet:

- Gjithsej 13 familje të ndihmuara gjatë muajve Janar – Qershor 2022 në shumë prej 1.250.00€.

Donacionet:

- 4 familje të ndihmuara me lëndë djegëse – dru
- 194 familje të ndihmuara me pako ushqimore, pako me mish, pako me batanije.
- Gjithsej 198 familje të ndihmuara gjatë muajve Janar –Qershor 2022.

-Aktivitet

ZKKK-ja takim pune me Këshillin Konsultativ për komunitetet jo-shumicë. Grupi punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale pranë zyrës së Presidentit/es të Republikës së Kosovës. Tema ishte "Gjendja e Komuniteteve jo-shumicë në punësim dhe si janë mundësitë për punësim në Republikën e Kosovës". ZKKK-ja informoi për gjendjen e Komuniteteve jo-shumicë në Komunën e Podujevës dhe angazhimin e institucioneve komunale për mundësitë e punësimit për një mirëqenie më të mirë socio-ekonomike për komunitetet jo-shumicë si në institucione edhe në sektorët privato-publik, që çdo herë e kemi parasysh koordinimin institucional mes institucioneve dhe kompanive privato-publike për mundësinë e punësimit për komunitetet jo-shumicë.

-Aktivitet:

Trajnim 4 ditor nga Këshilli i Evropës për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat e Minoriteteve, Arsimi Gjithëpërfshirës dhe Legjislacioni:

Ndërtimi i kapaciteteve për Arsimin Gjithëpërfshirës "INCLUDE" enkas për zyrtarët komunalë përgjegjës për Arsimin Gjithëpërfshirës si dhe punën e tyre me fëmijët nga grupet e cenushme (me nevoja të veçanta arsimore duke përfshirë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian). Ne si ZKKK në bashkëpunim me DKA-në, i paraqitëm të gjitha mundësitë tona institucionale për përfshirjen e të gjitha komuniteteve në arsim me mundësi të barabarta, pa diskriminim.

-Tryezë pune:

Me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) me mision në Kosovë, trajnim pune me temë: "Rritja e pjesëmarrjes së komuniteteve jo-shumicë në procesin e përgatitjes së buxhetit komunal në bashkëpunim me ZKKK-në dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, për stabilizimin dhe integrimin ekonomik për komunitetet jo-shumicë.

-Aktivitet:

ZKKK-ja në koordinim me DKA-në dhe IOM-in vizitua ato shkolla ku mësimin e ndjekin edhe nxënësit e komunitetit jo-shumicë dhe u informua që t'i ndihmojmë me paisje teknike për mësimnxënie në aftësimin e tyre profesional. Në shkollën fillore "Naim Frashëri" në bashkëpunim edhe me drejtorin e DKA-së dhe drejtorin e kësaj shkolle, erdhëm në përfundim se kjo shkollë ka nevojë për një kabinet me vegla muzikore dhe paisje tjera përcjellëse që do të realizohen me bashkëfinancim mes komunës dhe IOM-it. Njëkohësisht, e vizitua edhe SHFMU "Luigj Gurakuqi" në fshatin Batllavë ku mësimin e vijnë edhe nxënësit e komuniteteve jo-shumicë dhe u dakordua që kjo shkollë ka nevojë të pajiset me kabinete për lëndët; Fizikë, Kimi, Biologji, Gjeografi, Histori, inventar dhe pajisje tjera përcjellëse të nevojshme.

-Aktivitet:

ZKKK-ja në koordinim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK), UNHCR-në dhe përfaqësuesin e komuniteti serb, si dhe familjarë të komuniteti serb, me kërkesën e tyre kemi vizituar pronat dhe varrezat si dhe objektin e Kultit (Kishën Ortodokse-Serbe) në Komunën tonë si në qytet, dhe fshatrat: Zakut, Peran, Dumnicë. Livadicë, Shtedim, Merdarë dhe Metergoc, ku edhe u informuan për pronat e tyre. Vizita ishte "Shko, shiqo dhe informo".

-Aktivitet:

ZKKK-ja ka vizituar të gjitha lagjet: "Xhafer Meta", "Ali Ajeti", fshatin Batllavë, Sfeqël, Orllan,

Peran, ku banojnë komunitetet jo-shumicë dhe jemi informuar drejtpërdrejt me banorët e komuniteteve jo-shumicë dhe përfaqësuesit e tyre për jetën dhe gjendjen e tyre si në aspektin: socio-ekonomik, punësim, arsim, shëndetësi, banim, infrastrukturë etj. Kemi bashkëbiseduar edhe për mundësitë e Komunës për t'iu dalë në ndihmë këtyre komuniteteve.

-Aktivitet:

ZKKK-ja takim pune me Institutin e Prishtinës për Studime Politike (PIPS) dhe Qendra për Dialog Humanitar (HD). Tema kryesore ishte: “Sfidat e komuniteteve jo-shumicë dhe adresimi i tyre në këto fusha si: çështja ekonomiko-sociale, punësimi, arsimi, banimi, shëndetësia etj, ku ne si ZKKK i informuam për gjendjen e komuniteteve jo-shumicë në komunën tonë.

-Aktivitet:

Takim pune: Zyra e Kryeministrit / Zyra për Çështje të Komuniteteve, ku morën informata nga ZKKK-të. Nga komuna jonë e informuam këtë zyre për jetën dhe sfidat e komuniteteve jo-shumicë ku tema ishte “Inegrimi i komuniteteve jo-shumicë në nivelet komunale në të gjitha sferat e jetës ku i ndajmë edhe praktikën e mira dhe të arriturat në vazhdimësi në krijimin e kushteve për një jetesë dhe mirëqenie më të mirë socio-ekonomike për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën tonë. Këto i shpallorim përmes prezantimit tonë. Ne si institucione komunale çdo herë kemi qenë dhe do të jemi në shërbim të qytetarëve pa dallim.

Ne e përkrahim Zyrën e Kryeministrit për Komunitete. Misioni i Zyrës është që të gjitha komunitetet në Kosovë t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara për të gjithë qytetarët sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe të drejtat shtesë që ua mundësojnë atyre ruajtjen e identitetit dhe kulturës së tyre si dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqërinë kosovare.

-Aktivitet:

ZKKK-ja në koordinim me DKA-në dhe OJQ-në “Voice of Roma” (Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve), ku përmes organizimit të mësimit intenziv, plotësues për nxënësit e komuniteteve jo-shumicë në ato shkolla fillore ku i vijojnë mësimet. Ky program është mbështetur nga DKA-ja me personel arsimor nga komunitetet jo-shumicë ku janë financuar nga OJQ-ja “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve”, poashtu nga kjo OJQ janë përkrahur edhe nxënësit e shkollave të mesme të larta (SHML) si edhe studentët e komuniteteve jo-shumicë me bursa.

Me respekt,

PODUJEVË
20.07.2022

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK

Shefi i Zyrës për ZKKK: Liman ZEQIRI

Ylber SALIHU

Xhevrie BEQIRI

